

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

LIGJET DHE TATIMET NË KOSOVË

P4

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 13.02.2022

Pjesa A. Detyra me zgjidhje të shumëfishtë (vëtëm një opsion i saktë) Nga 2 pikë secila

1. Fatura në vlerë prej 22,880.00 Euro i dedikohet mallit për eksport , sa duhet te jete vlera e TVSH në këtë faturë?
 - a) 518.40 Euro;
 - b) 230.40 Euro;
 - c) 00.00 Euro;
 - d) 288. 00 Euro.

2. Banka Delta SH.A në muajin Janar 2022 ka pranuar një faturë në vlerë prej 6,300 EUR për shërbime konsulence nga furnitori jashtë vendit . Banka është e detyruar të përdor ngarkesën e kundër për këtë faturë. Ngarkesa e kundërt do të ketë ndikim në deklaratën e TVSH-se për muajin Janar 2022:
 - a) 1,134.00Euro rritja e TVSh –së të llogaritur;
 - b) 1,134.00 Euro rritja e TVSH-së të zbritshëm;
 - c) 1,134.00 Euro zvogëlim të TVSH-se se llogaritur
 - d) 1,134.00 Euro zvogëlim te TVSH-se të zbritshëm.

3. Edona për muajin Janar 2022 ka realizuar të ardhura neto nga punëdhënësi sekondar në shumë prej 620 EUR. Sa janë obligimet tatimore për këtë muaj që punëdhënësi sekondar duhet ndal në burim:
 - a) 62.00 Euro;
 - b) 68.89 Euro;
 - c) 39.80 Euro;
 - d) 70.00 Euro.

4. Edona për muajin Janar 2022 ka realizuar të ardhura neto nga punëdhënësi sekondar në shumë prej 620 EUR. Sa është shuma e kontributit pensional për këtë muaj që punëdhënësi sekondar duhet paguar si kombinim i pjesës së detyrueshme të pensionit nga e punësuar dhe punëdhënësi:
- a) 62.00 Euro;
 - b) 68.89 Euro;
 - c) 72.00 Euro;
 - d) 72.51 Euro.
5. Një shoqëri tregtarë si SH.P.K është e detyruar të regjistrohet për TVSH dhe të merr statusin e personit të tatueshëm, nëse brenda një viti kalendarik ka arrit qarkullimin bruto prej:
- a) Mbi 30,000.00 Euro;
 - b) Mbi 100,000.00 Euro;
 - c) 50,000.00 Euro;
 - d) Sipas vendimit të ATK-së.
6. Një biznes individual është i detyruar të regjistrohet për TVSH dhe të merr statusin e personit të tatueshëm, nëse brenda një viti kalendarik ka arrite qarkullimin bruto prej:
- a) Mbi 30,000.00 Euro;
 - b) Mbi 100,000.00 Euro;
 - c) Mbi 50,000.00 Euro;
 - d) Sipas vendimit të ATK-së.
7. Sipas Ligjit Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave në fuqi, shpenzimet e përfaqësimit janë të kufizuara mbi bazën e të ardhurave bruto vjetore si me poshtë:
- a) Deri ne 5% të qarkullimit bruto;
 - b) Deri ne 10% të qarkullimit bruto;
 - c) Deri ne 1% të qarkullimit bruto;
 - d) Deri ne 2% të qarkullimit bruto.

8. Kontributet e dhëna nga tatimpaguesit në fushën e sponsorizimeve të sportit, llogariten sipas Ligjit Nr. 05/L -090 për Sponsorizimë në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe shuma e lejuar është:
- a) Deri ne 20% të fitimit;
 - b) Deri ne 10% të fitimit;
 - c) Deri ne 20% të tatimit ;
 - d) Deri ne 30% te tatimit.
9. Sipas ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, shuma e lejuar si zbritje për zhvlerësim në periudhën tatimore për pasuritë e pa prekshme në grupin e trete sipas metodës lineare në fund të periudhës tatimore është me shkallen:
- a) Pesë përqind (5%);
 - b) Njëzet përqind (20%);;
 - c) Dhjetë përqind (10%). ;
 - d) Sipas marrëveshjes në kontratë ose 20 vite.
10. Sipas ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, nëse një tatimpagues blen asete të reja ose i vene në përdorim për herë të parë në Kosovë, si linjat prodhuese për uzina dhe makineri, inventar të hekurudhës dhe lokomotiva që shfrytëzohen për transportin hekurudhor, aeroplanë, anije, mjetet e rënda për transport, pajisjet për bartje të dheut, buldozerët, gërmuesit e dheut dhe mjetet tjera të rënda për qëllimet e aktiviteteve ekonomike të tatimpaguesit, përveç zbritjes normale të zhvlerësimit të lejueshëm, lejohet një zbritje e veçantë për vitin e parë:
- a) Pesë përqind (5%);
 - b) Njëzet përqind (20%);;
 - c) Dhjetë përqind (10%). ;
 - d) Ne varësi te llojit të asetit.

1. Sipas Ligjit në fuqi “Për Shoqëritë Tregtare”, këto janë llojet e shoqërive tregtare që mund të themelohen në Kosovë: si Biznes Individual, Ortakëri e Përgjithshme, Ortakëri e Kufizuar, Holding Kompani, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe Shoqëri Aksionare.

E saktë

E pasaktë

2. Sipas Ligjit në fuqi “Për Shoqëritë Tregtare”, me rastin e regjistrimit fillestar, Shoqërisë Tregtare ose subjekti tjetër i përcaktuar me këtë ligj, i lëshohet Numri Unik Identifikues i cili shërben njëkohësisht si numër për identifikimin e Shoqërisë Tregtare për qëllime të regjistrimit dhe për qëllime tatimore.

E saktë

E pasaktë

3. Numri i anëtareve në Bordin e Drejtorëve të Shoqërisë Aksionare duhet të përcaktohet në statutin e Shoqërisë Aksionare. Për një Shoqëri Aksionare me më pak se dhjetë (10) aksionarë, Bordi i Drejtorëve duhet të ketë tre (3) ose më shumë anëtarë. Për një Shoqëri Aksionare me dhjetë (10) ose më shumë aksionarë Bordi i Drejtorëve duhet të ketë jo më pak se 5 (pesë) anëtarë.

E saktë

E pasaktë

4. Numri i anëtarëve të Bordit të drejtorëve të shoqërisë aksionare duhet të përmbajë edhe kuoten prej pesëdhjetë përqind (50%) pjesëmarrje të grave në Bord.

E saktë

E pasaktë

5. Sipas Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, shoqëritë tregtare për qëllime të këtij Ligji, klasifikohen si: mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla, ndërmarrje të mesme dhe ndërmarrje të mëdha, mbi bazën e treguesve të përcaktuar në ditën e fundit të vitit të kaluar financiar, për qëllime të përgatitjes së pasqyrave financiare për vitin aktual, sipas këtyre kritereve: 1. pasqyra e pozitës financiare; 2. qarkullimi neto; dhe 3. numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar.

E saktë

E pasaktë

6. Ndërmarrjet e vogla janë ndërmarrje të cilat nuk janë mikro-ndërmarrje, por nuk tejkalojnë më shumë se dy(2) nga kriteret e mëposhtme: 1. pasqyra e pozitës financiare prej shtatëqind mijë euro (700,000.00 €); 2. qarkullimi neto prej katër milion euro (4,000,000.00 €); dhe 3. numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: dhjetë (10).

E saktë

E pasaktë

7. Pasqyrat financiare për ndërmarrjet e mëdha të përgatitura në përputhje me kërkesat e ligjit nënshkruhen nga drejtori ekzekutiv apo i përgjithshëm dhe nga drejtori financiar ose zyrtari kryesor financiar dhe/ apo nga kontabilisti i certifikuar.

E saktë

E pasaktë

8. Pasqyrat vjetore financiare të konsoliduara nuk përfshijnë pasqyrat financiare të një filiale, nëse nuk ka ndikim të rëndësishëm në këto pasqyra financiare dhe rezultatet e operacioneve të kompanisë mëmë..

E saktë

E pasaktë

9. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, një tatimpagues i cili ka detyrë të krijojë regjistra sipas këtij ligji do t'i mbajë ato regjistra për një periudhë prej së paku pesë vjet pas përfundimit të periudhës tatimore kur ka lindur një detyrim i tillë tatimor.

E saktë

E pasaktë

10. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, një tatimpagues mundet të dorëzojë një ndryshim deklarate tatimore nëse ai ose ajo më vonë zbulon gabim në deklaratën tatimore të cilën e ka dorëzuar tashmë. Afati për të dorëzuar një ndryshim deklarate është jo më vonë se gjashtë (6) vjet pas datës obligative kur deklarata është dorëzuar fillimisht.

E saktë

E pasaktë

11. Kushdo që kryen vepër penale në fushën e tatimeve apo merr pjesë në atë mënyrë të bashkëkryerjes, shtytjes apo ndihmës do të jenë bashkërisht dhe individualisht i detyruar për ikje të tatimeve. Detyrimi po ashtu do të përfshijë interesin në përputhje të ligj.

E saktë

E pasaktë

12. Sipas Ligjit ne fuqi Për Tatimin ne te Ardhurat Personale, Rrogat e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të jashtëm dhe zyrtarëve të punësuar vendor të Kombeve të Bashkuara dhe të agjencive të saj të specializuara dhe Agjencia Ndërkombëtare për Energji Atomike janë të ardhura të përjashtuara.

E saktë

E pasaktë

13. Sipas Ligjit ne fuqi Për Tatimin ne te Ardhurat Personale , dhuratat në para apo gjësende të pranuar nga rezidentët përfshihen në të ardhurat tjera, nëse dhuratat e tilla tejkalojnë shumën njëmijë euro (1.000 €) në një periudhë tatimore.

E saktë

E pasaktë

14. Sipas ligjit ne fuqi Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, çdo tatimpagues që bënë pagesa për personat fizik jo-afarist, bujqit, fermerët, grumbulluesit e materialeve recikluese, frutave të malit, bimëve mjekuese dhe të ngjashme me to, është i obliguar të mbajë tatimin në burim në shkallën prej një përqind (1%) në bruto pagesë, në momentin e pagesës.

E saktë

E pasaktë

15. Sipas ligjit ne fuqi Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, tatimpaguesit që paguajnë interes nga kreditë e marra duke përfshirë huazimet (me përjashtim të institucioneve financiare të licencuara nga BQK), apo të drejta pronësore personave rezident dhe jo rezident, mbajnë në burim tatimin në shkallën nëntë përqind (9%) në kohën e pagesës apo kreditimit.

E saktë

E pasaktë

16. Sipas ligjit te TVSh-se, kur pagesa duhet të bëhet apo është bërë në llogari para se mallrat dhe shërbimet të jenë furnizuar, TVSH-ja duhet të bëhet e ngarkueshme në pranimin e pagesës dhe në shumën e pranuar.

☐ E saktë

☐ E pasaktë

17. Sipas Ligjit te TVSH-se, çdo person i tatueshëm i regjistruar, mund të kërkoj nga ATK-ja, që të anulojnë regjistrimin e tij për qëllime të TVSH-së, nëse furnizimet totale gjatë dy viteve të fundit kalendarik kanë qenë nën pragun e regjistrimit. Çregjistrimi hyn në fuqi dy (2) muaj pas datës së paraqitjes së kërkesës, nëse aprovet nga ATK-ja.

☐ E saktë

☐ E pasaktë

18. Sipas Ligjit Për Fondet Pensionale të Kosove, kontributet nga të punësuarit e huaj me qëndrim të përkohshëm në Kosovë, nuk janë të lejuara..

☐ E saktë

☐ E pasaktë

19. Sipas Ligjit të Punës ne Kosovës, I punësuari ka të drejtë në pushim javor në kohëzgjatje prej së paku dyzetetë (48) orë pandërprerë.

☐ E saktë

☐ E pasaktë

20. Sipas Ligjit të Punës ne Kosovës, i punësuari nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç nuk mund të punoj në punët të cilat për nga natyra apo rrethanat nën të cilat kryhen, mund të dëmtojnë shëndetin, sigurinë apo moralin e tij.

☐ E saktë

☐ E pasaktë

Pjesa C. Pyetjet problemore

Problemi 1

10 pikë

E&L sh.p.k. regjistroi blerje gjate vitit 2021 në shumën Euro 213,000 me normë standarde ; blerje me normën e reduktuar Euro 20,000; shitjet vendore me normën standarde Euro 485,000; eksportet Eur 80 000; shitje të përjashtuara pa të drejte kreditimi Euro 141 900 (Vlerat e paraqitura janë pa përfshire TVSH-ne).

Deklarimet mujore për këtë vit janë bere duke shfrytëzuar koeficientin e vitit 2020 që ishte 70%.

Kërkohet:

- Sa ishte vlera e TVSH-se e zbritshme gjate vitit?
- Sa ishte vlera e TVSH-se e llogaritur gjate vitit?
- Sa ishte vlera e TVSH-se e pagueshme gjate vitit?
- Sa është koeficienti për këtë vit (2021)?
- Sa eshët shuma për rregullim të TVSH-së (TVSH e llogaritur apo TVSH e zbritshme)

Zgjidhje

$$\begin{aligned} \text{a)} \quad & 213,000 \times 18\% = 38,340 \times 70\% = 26,838 \\ & 20,000 \times 8\% = 1,600.00 \times 70\% = 1,120 \\ & \text{Totali} = 26,838 + 1,120 = 27,958 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned} \text{b)} \quad & 485,000 \times 18\% = 87,300 \\ & \text{Exp } 80,000 \\ & \text{SHP } 141,900 \\ & \text{TOTAL} = 87,300 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned} \text{c)} \quad & \text{TVSH e pag} = \text{TVSH e llogaritur} - \text{TVSH e zbritshem} \\ & = 87,300 - 27,958 = 59,342 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned} \text{d)} \quad & \text{PZ} = \frac{\text{Furnizimet e tatushme} + \text{Eksportet}}{\text{Furnizimet e tatushme} + \text{Eksporti} + \text{Furnizimet e perjashtuara}} \times 100 \end{aligned}$$

$$PZ = \frac{485,000 + 80,000}{485,000 + 80,000 + 141,900} \times 100 = \frac{565,000}{706,000} \times 100 = 0.80 \times 100 = 80\%$$

e) TVSH e zbritshme me 70% = 27,958

Rregullimi

$$213,000 \times 18\% = 38,340 \times 80\% = 30,672$$

$$20,000 \times 8\% = 1,600.00 \times 80\% = 1,280$$

$$\text{Totali} = 30,672 + 1,280 = 31,952$$

$$\text{Rritja e TVSH se zbritshme} = 31,952 - 27,958 = 3,994$$

Problemi 2

15 pikë

Kompania ndërtimore V & G Sh.A ka filluar projektin me ndërtim të larte që do të zgjat tre (3) vite. Bazuar në përlllogaritjet fillestare kompania planifikon të ardhura në tërësi nga projekti 8,000,000 euro (1,000 per m²) dhe një kosto e tërësishme 6,000,000 euro.

Viti i III- Kompania realizoj inkasimin e keshit nga marrëveshjet e shitjeve në vlerë prej 800,000 000 Eur.

Ky vite është përfundimi i projektit dhe është bërë pranimi teknik në fillim të Dhjetorit. Në fund të viti kjo është gjendja e kompanisë:

Llogari të arktushme 4,000,000 EUR

Shitja për m² 1000 EUR

Kostoja për m² rezultojë në fund të projektit 650 Eur

Informacion shtesë: për dy vitet e para të projektit ishin realizuar inkasim të keshit 2,500,000 EUR (2500 m²)

Kërkohet:

1. Sa ishte KMSH për m² e përlllogaritur
2. Sa është diferenca në mes të KMSH se përlllogaritur dhe reale?
3. Llogaritni obligimin tatimor për këtë vit sipas Ligjit Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, gjegjësisht trajtimi i kontratave afatgjata sipas këtij ligji duke marrë për bazë edhe rregullimin e KMSH-së .

Zgjidhje

KMSH e perlogaritur			
1	m2		
	shitjet (a)	cmimi I shtijes per m2 (b)	metrazha a/b
	8,000,000.00	1000	8,000
	Kostoja (a)	metrat (b)	KMSH m2 (a/b)
Kostoja e planifikuar	6,000,000	8000	750

2	* KMSH				
	shitjet (a)	cmimi I shtijes per m2 (b)	metrazha	kostoja per m2	KMSH
	4,800,000	1000	4,800	650	3,120,000
**KMSH rregullimet					
	KMSH e planifikuar	750			
	KMSH perfundimtare	650			
	Diferenca	100	2,500	100	250,000

Te ardhurate parashikuara	8,000,000		
Kosto e planifikuar	(6,000,000)		
Fitimi I planifikuar	2,000,000		
Tatimi I planifikuar	200,000		
Koha e perfundimit te kontrates	3 vite		
Viti III			
	Te ardhurat		

		Inkasim	800,000
		Ll.arkëtueshme	4,000,000
		TOTAL	4,800,000
Te ardhurat e tatushme	4,800,000		
*KMSH	(3,120,000)		
**KMSH e rregullar	250,000		
Fitimi I Tatushem	1,930,000		
TATIMI 10%	193,000		

Problemi 3

15 pikë

Kompania ELAN sh.p.k me seli në Prishtinë kryen aktivitete ekonomike tregtare dhe prodhuese në tërë teritorin e Kosovës. Gjatë muajit Janar 2022 ka pasur këto transaksione:

- i. shitjet brenda vendit me norme standarte - shuma e tatueshme 110,000 Euro;
- ii. shitjet brenda vendit me normë të reduktuar - shuma e tatueshme 5,000 Euro;
- iii. shitje të përjashtuara pa të drejte kreditimi 32,000 Euro;
- iv. shpenzime për shërbime konsulence të pranuar nga kompania jashtë vendit 8,000 Euro;
- iv. blerje vendore me normën standarde (lënda e pare) në vlerë 40,000 Euro;
- v. blerje e kamionit transportues brenda vendit në vlere 80,000 Eur;
- vi. shpenzimet tjera për aktivitet ekonomike me norme standarde 7,000 Euro;
- vii. shpenzimet tjera për aktivitet ekonomike me norme te reduktuar 3,000 Euro;
- viii. notë kreditore e pranuar me norme 18% ,vlere 9000 Euro shuma e tatueshme;
- ix. notë kreditore e lëshuar me norme 8%, vlere 5000 Euro shuma e tatueshme;

Koeficienti për vitin 2020 ishte 20% i cili do te shfrytëzohet për këtë muaj.

Të gjitha blerjet janë nga personat e tatueshëm;

Vlerat e paraqitura janë pa përfshire TVSH-në.

Kërkesa:

Përpiloni ekstraktin e deklaratës së TVSH-së sipas renditjes se sa ka pagesë/kreditim për muajin 01/2022.

Zgjidhje

[TV] FORMULARI I DEKLARIMIT TË TVSH2021

Periudha e Deklarimit: .01/2022
 Numri fiskal 800111222
 Emri I biznesit ELAN
 Emri I personit kontaktues SH.P.K
 Elon Pasha

Furnizimet			
Shitjet e liruara pa te drejtë kreditimi	[9]	32,000	
Shitjet e liruara me drejtë kreditimi	[10]		
Eksportet	[11]		TVSH e llog
Shitjet e tatushme me normën 18%	[12]	110,000	[13] 19,800.00
Shitjet e tatushme me normën 8%	[14]	5,000	[15] 400.00
Nota debitore e leshuar,nota kreditore e pranuar me normë 18%	[16]	9,000.00	[17] 1,620.00
Nota debitore e leshuar,nota kreditore e pranuar me norme 8%	[18]		[19]
Fatura e borxhit te keq e pranuar, inkasimi I B.K me normë 18%	[20]		[21]
Fatura e borxhit te keq e pranuar, inkasimi I B.K me normë 8%	[22]		[23]
Rregulimet per te rritur TVSH-në me normë 18%	[24]		[25]
Rregulimet per te rritur TVSH-në me normë 8%	[26]		[27]
Blerjet qe I nënshtrohen ngarkesës së kundërt	[28]	8000	[29] 1,440.00
			[30] 23,260.00
		Blerjet	Totali I TVSH së llog
Blerjet dhe importet pa TVSH	[30]	134352	
Blerjet dhe importet investive pa TVSH	[31]		
Blerjet dhe importet meTVSH jo te zbritshme	[33]		
Blerjet dhe importet investive meTVSH jo te zbritshme	[34]		*Tvsh e zbrit
Importet me normë 18%	[35]		[36] -
Importet me normë 8%	[37]		[38] -
Importet investive me normë 18%	[39]	16,000.00	[40] 2,880.00
Importet investive me normë 8%	[41]		[42]
Blerjet vendore me normë 18%	[43]	9,400.00	[44] 1,692.00
Blerjet vendore me normë 8%	[45]	600.00	[46] 48.00
Blerjet investive vendore me normë 18%	[47]		[48]
Blerjet investive vendore me normë 8%	[49]		[50]
Blerjet nga feremrët vendore me normë 8%	[51]		[52]
Nota debitore e pranuar,nota kreditore e lëshuar me normë 18%	[53]		[54]
Nota debitore e pranuar,nota kreditore e lëshuar me normë 8%	[55]	1000	[56] 80
Fatura e borxhit te keq e lëshuar, pagesa e borxhit të keq me normë 18%	[57]		[58]
Fatura e borxhit te keq e lëshuar, pagesa e borxhit të keq me normë 8%	[59]		[60]
Rregulimet per te ulur TVSH-në me normë 18%	[61]		[62]
Rregulimet per te ulur TVSH-në me normë 8%	[63]		[64]
E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt me normë 18%	[65]	1600	[66] 288
			[67] 4,988.00
		Kalkulimi	Totali I TVSH

Teprica e TVSH-së e bartur nga muaji I kaluar	[68]		së Zbr
Balanca kreditore e mbetur $69=((67+68)-30)>0$	[69]		
Kërkesa për rimbursim	[70]		
Kreditimi I tvsh-së për muajin pasues $71=(69-70)$	[71]		
TVSH që duhet te paguhet $72=(30-67-68)>0$	[72]	18,272.00	

*TVSH e zbritshme

[39]	Blerja	Norme	TVSH	[30]
	80,000.00	18%	14400	
20% e pranuar	16,000.00	18%	2880	
Dif Blerje pa TVSH	64,000.00	-	11520	75,520.00
[43]	47,000.00	18%	8460	
20% e pranuar	9,400.00	18%	1692	
1 Dif Blerje pa TVSH	37,600.00	-	6768	44,368.00
[45]	3,000.00	8%	240	
20% e pranuar	600.00	8%	48	
1 Dif Blerje pa TVSH	2,400.00	-	192	2,592.00
[55]	5,000.00	8%	400	
20% e pranuar	1,000.00	8%	80	
1 Dif Blerje pa TVSH	4,000.00	-	320	4,320.00
[65]	8,000.00	18%	1440	
20% e pranuar	1,600.00	18%	288	
1 Dif Blerje pa TVSH	6,400.00	-	1152	7,552.00
TOTAL				134,352.00

Problemi 4

7 pike

Kompania Marsi sh.p.k. ka bere deklarimin e TVSH për muajin 05/2021 me datë 25.08.2021. Obligimi tatimor i dale nga deklarata e këtij muajit në vlere prej 8,200 Eur ishte paguar me date 05.10.2021.

Sa janë gjobat dhe interesi për këtë vonese deklarimi dhe pagese para dhe pas zbatimit te zbritjes se sanksioneve bazuar ne përllogaritjen qe parasheh Ligji mbi Procedurat dhe Administratën Tatimore?

Zgjidhje

Para zbatimit te zbritjes se sanksioneve

1. Gjoba për mos dorëzim te deklaratës ne kohe 5% ne muaj (3 muaj)	$8,200 * 15\% = 1,230$
2. Gjoba për mos pagese në kohe 1% muaj (2muaj)	$8,200 * 2\% = 164$
3. Interesi 0.65% ne muaj (5 muaj)	$8,200 * 3.25\% = 266.50$
TOTALI i ndeshkime	1,660.50

Para pas zbatimit te zbritjes se sanksioneve

1. $8,200 * 15\% = 1,230$	$1,230 * 25\% = 307.50$
2. $8,200 * 2\% = 164$	$164 * 25\% = 41.00$
3. $8,200 * 3.25\% = 266.50$	no = 266.50
TOTALI i ndëshkimeve	615.00

Problemi 5

5 pike

Kompania LANA Sh.p.k gjate viti 2021 shiti një gërmues dheu në shume prej 32,000 EUR, ky aset ishte blere nga kompania në fillim të viti 2017 me kosto 120,000 EUR.

Kärkoht:

1. Te llogaritet fitimi apo humbja kapitale nga shitja e asetit për qëllime tatimore
2. Përllogaritni tatimin nga shitja e asetit nëse ka.

Zgjidhje

Viti I blerjes		2017					
Vlera e blerjes	120,000.00	Norma e zhvler	Viti I I	Viti II	Viti II	Viti IV	Zhvle Total
	Kostoja						
Zhvleresimi	120,000	20%	24,000	24,000	24,000	24,000	96,000

Vlera e mbetur per tatime

Vlera blerese	120,000.00
Zhvleresimi	<u>(96,000.00)</u>
Vlera e mbetur	24,000.00

Shitja	32,000.00
Vlera e mbetur	(24,000.00)
Fitimi kapital	8,000.00
Tatimi 10%	800.00

Problemi 6**8 pike**

Shendi ishte punësuar në kompaninë SOFT në muajin Qershor 2021 me një pagë bruto 750 Eur për muaj. Poashtu Shendi në muajin Tetor realizoj një të ardhur shtesë nga një punë sekondare 900 Eur neto.

Kërkohet:

1. Llogaritni detyrimin e tatimit në paga që është mbajtur në burim nga punëdhënësi kryesor dhe sekondar për vitin 2021 si dhe kontributin pensional.
2. Të përgatitet deklarata përfundimtare (PD) për Shendin për vitin 2021 sipas Ligjit Për Tatimin në te Ardhurat Personale.

Zgjidhja

Paga Primare Tatimi	750				
Baza e tatushme Sipa Shkallve mujore		Baza	Norma		
0-80	750	0	5%	37.5	713
80-250	170		4%	6.8	
250-450	200		8%	16	
450-712.50	262.5		10%	26.25	
Totali mujore				49.05	
Totali I mbajtur ne burim		49.05	7	343.35	

Pensioni Mujor Viti	750	I punesuari 5%	Punedhensi 5%	Total	
	75	37.5	37.5	75	
		7		525	
Paga sekondare	Neto	Baza e tatushme	Bruto		
	900	1000	1052.63		
		I punesuari 5%	Punedhensi 5%	Total	

Pensioni	1052.63	52.63	52.63	105.26
Tatimi	1,000.00	10%		100.00

Deklarat PD		*Te ardhurat primare	Te ardhurat sekondare te tatushme	Total	
	Baza e tatushme	4987.5	1000	5987.5	
	Sipa Shkallve vjetore	Baza	Norma		
	0-960	0			
	960-3000	2040	4%	81.6	
	3000-5400	2400	8%	192	
	5400-5987.50	587.5	10%	58.75	
	Obligimi vjetor			332.35	
	**Totali I mbajtur ne burim			443.35	
	Rimbursim			-111.00	

	per muaj	muaj	Total
*Te ardhurat primare	712.50	7	4987.5
	Punedhenesi primar	Punedhenesi sekondar	
**Totali I mbajtur ne burim	343.35	100.00	443.35